

25/05/2018

AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE TREGETARE "STONE CENTER AL" sh.p.k.

Ne baze te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" dhe te ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare edhe prodhuese ne Republiken e Shqiperise, me vullnetin e tyre te lire , shtetasi Shqiptar **LUAN HASA**, i biri i Rakip, i datelindjes 09.05.1973, lindur ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, i identifikuar ne baze te pashaportes me numer BF0951124 dhe numer personal H30509063V,leshuar me date 18.08.2010,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar dhe shtetasi Italian **ANGELO SAORIN** atesia,Mario , i datelindjes 03.03.1958, lindur ne Alba (Cn) VIA TELESTAR 13 ,me permeso di Dimora me adrese ne Via alla Chiesa 1 6825 Capolago CH e vlefshme per ne Svicer deri me date 30.11.2022 i identifikuar me karte identiteti Italiane numer N.AT 8731670 me skadence me date **03.03.2024** kane vendosur krijimin e akt themelimit te shoqerise **STONE CENTER AL sh.p.k.**

NENI 1


THEMELIMI I SHOQERISE


Ortaket e vetem themelues -jane shtetasi Shqiptar LUAN HASA dhe shtetasi Italian ANGELO SAORIN te shoqerise **STONE CENTER AL sh.p.k.** themelon

Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar e te emertuar **STONE CENTER AL sh.p.k.**

Shoqeria, e formuar me iniciativen e ortakeve themelues, konsiderohet e themeluar ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkangjitur ketij akti.

Shoqeria i nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen jashte territorit te Republikes se Shqiperise do t'i nenshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete qendren dega.Deget e shoqerise do te ushtrojne veprimtarine ne emer dhe per llogari te kesaj shoqerie dhe brenda kopetencave qe do tu jene dhene me aktet e krijimit apo me akte te tjera te vecanta.

Saorin Angelo


Hasa Luan


**NENI 2
E DREJTA**

Shoqeria **STONE CENTER AL sh.p.k.** eshte person juridik i se drejtes shqiptare e themeluar me vendim te ortakeve themelues qe ushtrojne veprimtarine e tyre tregtare ne perputhje dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar ne fuqi si ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" .

**NENI 3
PERGJEGJESIA**

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar. Shoqeria pergjigjet me pasurine e saj per detyrimet i saj ndaj te treteve. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut ne vecanti, po per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

**NENI 4
SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria e ka seline e saj ne Lagja 28 Nentori,Elbasan ,me numer pasurie 8/85 ,zona kadastrale 8523,Rruga Abdyl Frasheri ,prane Drejtorise se Tatim Taksave Elbasan . Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjenci operative ne te gjithë territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit.


**NENI 4
KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 10 vjet me perjashtim te rastit kur ortaku vendos nje prishje te parakohshme te saj ose vendos per shtytje te metejshme, etj.

**NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se saj do te jete:

-Agjensi Shitje ,shit-blerje ,tregtim me pakice dhe shumice ,transformim ,punim,ushtrim veprimtarie ,transport kombetar dhe nderkombetar te artikujve te ndryshem dhe pjeseve te kembimit per automjete,import- eksport te mallrave te ndryshme ,makineri te cdo lloj fushe te industrise,blerje trojesh ,blerje shoqerish ,dhenie konsulence ,agjent shitje .-----

Sasim Anxelo


Haxhi Riza


NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (nje qind mije) leke i perbere nga kontributi i ortakeve . Ky kapital ndahet dhe vlere e kapitalit themeltar ndahet ne dy pjese(dy kuota) me vlere nominale prej 50.000 leke , kuota te cilat mund te tjetersohen pjeserisht ose teresisht.

Ndarja do te jete si me poshte vijon :

.Luan Hasa me 50% te pjesmarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise ,eshte zoterues i 1 (nje kuote)me vlere 50.000 leke .-----

Z.Angelo Saorin me 50%te pjesmarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise eshte zoterues i 1 (nje kuote)me vlere 50.000 leke .-----

NENI 7
VULA E SHOQERISE

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje: **STONE CENTER AL sh.p.k.**

NENI 8
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- Mbledhja e Ortakeve - Ortaku i Vetem
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet ne statut.

NENI 9

Ne perputhje me ligjin per ushtrimin e ketij aktiviteti, shoqeria ka te drejten e emerimit apo dhe te shkarkimit te Drejtuesit Teknik te saj.



Kopetencat dhe detyrat e Drejtuesit Teknik jane te percaktuara ne stutin e shoqerise.

Administrator i **STONE CENTER AL sh.p.k.**eshte **LUAN HASA** .

Afati i qendrimit ne detyre te Administratorit eshte 5 vjet me te drejte rizgjedhjeje.

NENI 10
BAZA LIGJORE PER NDRYSHIMET

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, administratoret, kapitalin, seline, ortaket, objektin e veprimatrise, etj, sipas vendimit qe do te merret nga Mbledhja e Ortakeve-Ortaku i Vetem dhe sipas kerkesave te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite Trgetare" duke depozituar vendimin prane rregjistrir tregetar te Qendres Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 11

LLOGARITE

Shoqeria do te realizoje transaksionet e saj financiare nepermjet llogarive rrjedhese qe do te hape ne bankat shqiptare dhe te huaja. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive dhe shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin financiar ne perputhje me dispozitat ne fuqi per kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale.

NENI 12

BILANCI

Veprimet ekonomike dhe financiare te shoqerise do te mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti. Viti ushtrimor do te perkoje me vitin kalendarik. Vetem per vitin e pare ushtrimor do te kihet parasysh periudha qe shtrihet nga momenti i rregjistrimit ne organin tatimor deri ne daten 31 dhjetor.

NENI 13

PERFAQESIMI

E drejta per te perfaqesuar shoqerine para cdo organi shteteror, privat, bankar , gjyqsor , etj ushtrohet nga Administratori i Shoqerise ose nga nje person tjetër i autorizuar me prokure nga Administratori.

NENI 14

ZBATIMI I LIGJIT

Persa nuk eshte shprehur ne kete Akt Themelimi dhe Statut, vlejne dispozitat e Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregetare" ; Ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" dhe ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregetare ne Republikën e Shqiperise.

NENI 15

VLEFSHMERIA E AKTIT TE THEMELIMIT

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij akti – themelimi e te statutit bashkelidhur aktit.

NENI 16

Ky akt perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

ORTAKET

Savin Angel
Seon

Hasan...
4